



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE KURBIN

Nr.5348 Prot.

Laç, me 01.10.2019

V E N D I M - S H P A L L J E

(Lidhur me ekzekutimin e "Urdherit të Ekzekutimit" të titullit ekzekutiv të debitorit)

Ne Laç, sot me date 01.10.2019

Une, Rovena Prenga, me detyrë Permbaruese Gjyqësore pranë Zyres Permbarimore Kurbin, pasi studiova aktet procedurale të çështjes permbarimore Nr. 630 rregj. të vitit 2019 bazuar në urdherin e ekzekutimit Nr.153 date 30.07.2019 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës,

KONSTATOVA:

Se në datë 20.08.2019 është depozituar pranë Zyres së Permbarimit kërkesa e kreditorit Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës së bashku me "Urdherin e Ekzekutimit" të Titullit Ekzekutiv (vendim gjyqësor) nr.844(154) date 04.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, me palë dhe objekt:

- Kreditor: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës
- Debitor: Samuel Gjergj Pupuleku I dtl.30.12.1979, Laç, rruga Previzi nr.5.
- Me objekt: Shpenzime procedurale në vlerën 1.000 leke + 120 leke për TFP dhe TVSH e saj.

Nga ana e zyrë tone permbarimore kanë filluar procedurat në bazë të nenit 515 e vijues të K.Pr.Civile si dhe ligjit 8730 date 18/01/2001 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Sherbimit Permbarimor Gjyqësor" i ndryshuar për ekzekutimin e detyrueshëm të Titullit Ekzekutiv të sipërcituar.

Nga verifikimi i kryer nga ana jone në bashkëpunim me organet kompetente rezultoi se debitori Samuel Gjergj Pupuleku nuk ka marrë dënimin nepermjet sherbimit postar, si rezultat i kësaj bazuar në nenin 133/a, 133/b dhe 144/a si dhe 517 të K.Pr.Civile duhet të bëhet njoftimi me shpallje publike i debitorit lidhur me detyrimin që ai ka ndaj palës kreditore Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës për shpenzime procedurale në vlerën 1.000 leke + 120 leke për TFP dhe TVSh-në mbi këto tarife, gjithsej 1.120 leke.

Sa me sipër në mbështetje të Nenit 133/a, 133/b dhe 144/a si dhe 517 të Kodit të Procedurës Civile, ligjit Nr.8730 date 18/01/2001 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Sherbimit Permbarimor Gjyqësor", i ndryshuar

V E N D O S A

1-Te kryej njoftimin nepermjet shpalljes publike me afat 20 (njetzet) ditor (duke marrë parasysh edhe komunikimin postar) nga data 01.10.2019 – 20.10.2019 të debitorit; Samuel Gjergj Pupuleku I dtl.30.12.1979, Laç, rruga Previzi nr.5, NID.H91230140V.

2-Ky vendim përpilohet në disa kopje, ku një kopje afishohet në vendbanimin e fundit të palës debitore, një kopje afishohet në këndin e njoftimeve të kësaj zyre, një kopje dërgohet për afishim në ambientet e Bashkisë Kurbin, një kopje dërgohet për afishim në ambientet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe një kopje i dërgohet për publikim në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Permbarimit të Tiranës.

3-Kjo shpallje publike ka vlerën e aktit të njoftimit për palën debitore; Samuel Gjergj Pupuleku I dtl.30.12.1979, Laç, rruga Previzi nr.5.

4-Palë debitore Samuel Gjergj Pupuleku I dtl.30.12.1979, Laç, rruga Previzi nr.5, duhet të paraqitet pranë Zyres Permbarimore Kurbin me seli në Lgji nr.4 Laç në katin e parë në ambientet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe të marrë kontakt me permbaruesin gjyqësor të çështjes permbarimore për t'iu vënë në dispozicion aktet permbarimore, pasi me kalimin e këtij afati do të vijohet me ekzekutimin e detyruar sipas parashikimeve të nenit 519 e në vijim të K.Pr.Civile.

U shpall, sot me date 01.10.2019.

PERMBARUES GJYQËSOR
ROVENA PRENGA

